



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME

2007

PLANI I INTEGRUAR I MINISTRISË



## Mesazhi i Ministrit

Ministria e Brendshme, në kuadër të zbatimit të Programit të Qeverisë 2005-2009 dhe sidomos të objektivave të saj për vitin 2007, nëpërmjet masave të Planit të Integruar, angazhohet që të përmbushë prioritetet që lidhen me sigurinë publike, luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, forcimin e kufirit dhe menaxhimin e integruar të tij, etj. Kjo Ministri, synon gjithashtu, plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe nga dokumentet e tjera të rëndësishme, për politikën e qeverisjes vendore, administratën publike, regjistrin kombëtar të gjendjes civile, paisjen e shtetasve shqiptarë më kartën e identitetit dhe sidomos në përmirësimin e shërbimit që i ofrojmë komunitetit.



Këto prioritete, do të realizohen nëpërmjet hartimit të strategjive të zhvillimit, planifikimit e përdorimit efektiv të fondeve buxhetore dhe të donacioneve të ndryshme, të cilat synojnë në përmirësimin e infrastrukturës, rritjen e kapaciteteve planifikuese dhe manaxhuese, rritjen e investimeve, si dhe implementimin e reformave, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e performancës së punës të Ministrisë së Brendshme.

**Bujar Nishani**

**Minister i Brendshëm**

## Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë.....	2
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë .....	4
3	Programet buxhetore të Ministrisë .....	9
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007.....	11
5	Plani i Monitorimit të Ministrisë .....	19
Aneks 1	Projekt-ligjet për tu paraqitur .....	20
Aneks 2	Rezultate që lidhen me Programin e Qeverisë .....	23
Aneks 3	Rezultate që lidhen me Integrimin European .....	24
Aneks 4	Investimet publike .....	25
Aneks 5	Projekte të ndihmës së huaj .....	26

# 1 Misioni i Ministrisë

Forcimi e garantimi i rendit e sigurisë publike, individuale e komunitare do të përbëjë angazhimin parësor të mazhorancës së re dhe qeverisë së saj. Motoja e Qeverisë është: "Tolerancë zero ndaj krimit".

## Lufta kundër krimit të organizuar e trafikëve

Lufta kundër krimit të organizuar, trafikëve në përgjithësi dhe atyre të drogës e qenieve njerëzore në veçanti, si dhe lufta kundër pastrimit të parave do të kenë përparësi. Për këtë qëllim do të bëhen edhe ndryshime ligjore në kodin penal për dënime maksimale dhe nivel të prerë dënimi për këto vepra penale.

## Angazhimi në luftën kundër terrorizmit

Shqipëria do të përmbushë në mënyrë aktive dhe të përkushtuar të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e saj në luftën globale kundër terrorizmit si rreziku dhe armiku numër një i paqes, sigurisë dhe jetës së popujve.

## Ulja dhe parandalimi i krimit ordiner

Krimi ordiner do të ndëshkohet por lufta kundër tij do të gërshetohet edhe me masat efektive parandaluese. Qytetet, fshatrat, rrugët, rrugicat, bankat e bizneset, lokalet dhe stadiumet dhe çdo cep i vendit do të jenë tërësisht të garantuara dhe siguria publike do të jetë solide dhe e plotë. Në qytetet e mëdha do të investohet në sistemet e monitorimit të pandërprerë elektronik. Organet e rendit publik do t'i nënshtrohen një reforme të thellë në organizimin, shpërndarjen, komandimin, marrëdhëniet me komunitetin, përgatitjen profesionale dhe sigurimit të burimeve njerëzore si dhe do të bëhen të afta të japin edhe shërbime speciale të sigurisë.

## Siguria rrugore

Siguria rrugore do të trajtohet gjithashtu me përparësi. Niveli i ulët i sigurisë rrugore merr çdo vit me dhjetar jetë njerëzish dhe shkakton dëme materiale të konsiderueshme. Krahas përmirësimit të cilësisë së rrugëve dhe sinjalistikës rrugore në përputhje me standardët evropiane, përfshirë zbatimin e procedurave të auditimit të rrufeve që nga momenti i projektimit e deri në realizim, forcimi i disiplinës së qarkullimit rrugor, pajisa me leje qarkullimi bazuar në testime realiste dhe të pa korruptuara të drejtuesve të mjeteve nëpërmjet përmirësimit të sistemit të auto-shkollave, ristrukturimi i kontrollit teknik të mjeteve dhe edukimi masiv me rregullat e qarkullimit të të gjithë grupmoshave, veçanërisht të moshës shkollore, do të jenë disa nga drejtimit kryesore. Policia rrugore në bashkëpunim me atë bashkiake do të jenë jo vetëm ndëshkuese të rasteve të shkeljes së rregullave të qarkullimit por ato do të shndërrohen në institucione në shërbim të qytetarëve.

## Decentralizimi dhe autonomia vendore

Qeveria, në projektin e saj të ndryshimit, do të zbatoje, në përputhje me kartën evropiane të autonomisë lokale dhe rajonale, me ritme të përshpejtuara dhe të qëndrueshme, dhe në konsultim të vazhdueshëm me qeverisjen vendore e aktoret e tjerë të interesit, reformën e decentralizimit të pushtetit ekzekutiv pasi vlerëson se decentralizimi përmirëson cilësitë qeverisëse qofte në drejtim të eficientes dhe efektivitetit po aq edhe në drejtim të forcimit të përgjegjshmërisë, rritjes së transparencës si dhe rritjes së përfshirjes së qytetarëve dhe komuniteteve e grupeve të ndryshme shoqërore në qeverisje. Në qeverisjen e re do të marrin

fund diskriminimi i njësive të qeverisjes vendore për shkak të përkatësisë politike dhe zvarritja e tejskajshme e zbatimit të strategjisë kombëtare të decentralizimit e të ligjit organik të qeverisjes vendore. Deri në fund të periudhës 4 vjeçare: do të dyfishohet pesha aktuale e shpenzimeve autonome të pushtetit vendor në buxhetin e shtetit dhe në PBB të lidhura me funksionet e veta të qeverisjes vendore dhe do të zgjerohet autonomia fiskale e bashkive dhe komunave, të cilat do të vendosin dhe mbledhin vetë taksat dhe tarifatat vendore. Ndërkaq, transfertat nga buxheti i shtetit drejt autoriteteve lokale do të rriten me 3-4 here krahasuar me nivelin e sotëm duke u kryer në mënyrë transparente e objektive bazuar në formule analitike.

Brenda dy vitesh do të përfundojë procesi i transferimit të pronave në njësitet e qeverisjes vendore, me përparësi ujësjellësit, rrugët, trojet, shoqëritë publike me karakter vendor, objektet social-kulturore. Do të vihet në zbatim koncepti i funksioneve të përbashkëta në arsim, shëndetësi, mjedis, strehim, shërbime sociale, rend dhe qarkullim rrugor, për të cilat njësitet e qeverisjes vendore do të marrin vendime autonome brenda sferës së juridiksionit të tyre dhe do të bashkëpunojnë, bazuar në principin e autonomisë, subsidiaritetit dhe të partneritetit, me qeverisjen qendrore si dhe mes vetë njësive të qeverisjes vendore, për arritjen e objektivave kombëtare në këto fusha, sipas prioriteteve vendore për secilën prej këtyre njësive. Alokimi i fondeve për qeveritë vendore në këta sektorë publike do të kryhet në mënyrë objektive dhe transparente, duke synuar ngushtimin e disbalancave rajonale të derisotme.

Kufijtë e njësive të qeverisjes vendore janë të garantuara me ligj. Çdo ndryshim i mundshëm i tyre do të bëhet në favor të progresit e mirëqeverisjes dhe sipas procesit të hapur e përfshirës bazuar në parimet e Kushtetutës dhe të ligjit organik të qeverisjes vendore

## **Reformimi i ekzekutivit qendror dhe administrata publike**

Në projektin e saj të ndryshimit mazhoranca e re angazhohet për një qeveri në shërbim të qytetarëve dhe të shërbësve me të mira ndaj qytetarëve. Qeveria do të kryejë një reforme të thellë e të vërtetë të administratës publike për krijimin e një rrjeti institucional efektiv dhe eficient, si dhe të një administrate të qëndrueshme, të përkushtuar ndaj zbatimit të ligjit dhe të ofrimit të shërbimeve me të mira për qytetarët, e aftë të prodhojë e të zbatojë politika, me nënpunës civile të rekrutuar dhe të vlerësuar sipas kualiteteve profesionale, eksperiencës, meritës dhe përkushtimit në kryerjen e detyrave.

Mazhoranca e re angazhohet për një qeveri të vogël njëherazi në diete. Shpenzimet qeveritare të natyrës jo-produktive e të luksit do të eliminohen ndërsa do të përgjysmohen shpenzimet administrative të qeverisë në tërësi. Ministrinë dhe të gjitha institucionet e tjera ekzekutive do të bëjnë transparente dhe me zyrat e informimit të publikut të gjithë veprimtarinë e tyre. Ministrinë dhe institucionet e tjera në varësi të qeverisë do të ristrukturohen ndërsa do të mbyllën ose shkurtohen një rrjet i tërë institucionesh e zyrash parazitare.

Administrata publike do të forcohet e konsolidohet sipas principeve të shërbimit publik, mbi bazën e meritës dhe të performancës. Mazhoranca e re njeh dhe respekton statusin e nëpunësit civil të çdo punonjësi që e ka fituar atë me meritë dhe ai do të jetë i garantuar. Qeveria do të përmirësojë kualitetet profesionale në administratën publike nëpërmjet një procesi të hapur e konkurrues rekrutimi e karriere, motivimi e shpërblimi të performancës së mirë dhe ndëshkimit të performancës së dobët e pandershmerisë së nëpunësve si dhe trajnimin të vazhdueshëm. Statusi i nëpunësit civil do të shtrihet në pjesën më të madhe të organeve të administratës publike, ndërsa pagat në sektorin publik do të rriten njëkohësisht me ngushtimin në 1 me 5 të diferencave të mëdha që ekzistojnë sot mes pagës maksimale dhe minimale.

## 2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

### Strategjia sektoriale e rendit publik

Plani Strategjik 7-vjeçar i Policisë së Shtetit është i pari dokument i këtij lloji dhe do të shërbejë për të projektuar politika me qëllim sigurimin e suksesit afat-gjatë të organizatës së policisë. Është në proces miratimi.

### Strategjia ndërsektoriale e decentralizimit

Në 6-mujorin e dytë të vitit 2006, është punuar për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Decentralizimit. Rishikimi i kësaj strategjie erdhi si nevojë e nivelit dhe stadi aktual të zhvillimit të reformës së decentralizimit, ku një pjesë e objektivave tashmë të këtij dokumenti janë plotësuar, gjithashtu programi i Qeverisë së re Demokratike 2005-2009, përmban disa objektiva dhe masa në drejtim të thellimit të procesit të decentralizimit dhe rritjes së shpejtësisë së zhvillimit të kësaj reforme. Në rishikimin e këtij dokumenti u përfshinë, ministrinë e linjës, sektorët e të cilave janë të lidhura me procesin e decentralizimit dhe pushtetin vendor nëpërmjet shoqatave të tyre (shoqata e bashkive, komunave dhe qarqeve), aktor të shoqërisë civile Shqiptare si dhe donatore dhe ekspertë të huaj që e kanë asistuar procesin e decentralizimit në Shqipëri për një kohë të gjatë. Ekspertët e Ministrisë së Brendshme dhe Grupi i Ekspertëve të Decentralizimit (GED) ka bërë disa takime me aktorët e përmendura më sipër ku është debatuar dhe janë shpalosur pikëpamjet dhe qëndrimet rreth këtij dokumenti. Me qëllim bërjen e një dokumenti sa më të plotë dhe cilësor në tremujorin e parë të vitit 2007, do të bëhet edhe një konsultim me të zgjedhurit e rinj dhe pastaj ky dokument do të miratohet në GED dhe në Komitetin Ndërministror për Decentralizimin.

### Strategjia sektoriale e gjendjes civile dhe e kartave të identitetit

Projekti për " Modernizimin e Shërbimit të Gjendjes Civile " është përgatitur pas konsultave dhe takimeve të shumta me specialistë të organizatave ndërkombëtare si OSBE-ODIHR, STATISTIK NORWAY dhe pritet raporti përfundimtar i këtyre specialistëve, i cili do t'i hapë rrugë realizimit të etapave të mëtejshme të këtij projekti.

Për sa i përket Projektit për "Dokumentin e Identitetit", është miratuar në parim Projekti për "Prodhimin dhe shpërndarjen e dokumentit të identitetit dhe pasaportave elektronike të shtetasve shqiptar". Gjithashtu, është miratuar fondi shtesë për Ministrinë e Brendshme për realizimin e këtij projekti. Për të bërë të mundur realizimin e projektit, është ngritur Grupi i Punës Ndërministror dhe është nisur për miratim në Këshillin e Ministrave projektvendimi për "Caktimin e elementëve të sigurisë, formën dhe modelin e dokumentit të identitetit". Miratimi i VKM-së për miratimin e Projektit për "Modernizimin e shërbimit të Gjendjes Civile" dhënie e Fondit të Ministrisë së Brendshme dhe Miratimin e Komitetit Drejtues të Projektit.

### Strategjia ndërsektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafikut dhe terrorizmit

Në Grupin Teknik të Punës për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve dhe Terrorizmit, marrin pjesë përfaqësues nga Ministria e Brendshme si Drejtoria e Luftës kundër Krimit të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve, Drejtoria kundër Krimeve të Hapura dhe Akteve Terroriste, Drejtoria e Policisë Kufitare dhe Migracionit, Ministria e Drejtësisë, nga Ministria e Financave si dhe nga Ministria e Mbrojtjes. Më 15 Tetor 2006, u dërgua në Këshillin e Ministrave për sugjerime dhe komente drafti i parë i kësaj strategjie. Në bazë të sugjerimeve dhe komenteve të Këshillit të Ministrave, konstatohet se nuk është kryer një përmirësim i draftit të Strategjisë së lartpërmendur pasi formati nuk përputhet me udhëzimet e dhëna dhe përmbajtja e strategjisë kërkon përmirësime të mëtejshme. Pa u kryer përmirësimi i kësaj Strategjie në përmbajtje, është e pamundur që kjo Strategji të konsultohet me Grupet e Këshillimit (ICITAP, PAMECA, EURALIUS, WORLD BANK, INTERFORZA, UNDP etj). Ftesë për pjesëmarrje në Grupin Këshillimor, ju është komunikuar edhe institucioneve të

pavarura shtetërore si: Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Krimeve të Rënda, Prokurorisë së Përgjithshme si dhe Zyrës së Mbrojtjes së Qytetarëve.

Ndër dokumentet strategjike të miratuara për këtë fushë është Strategjinë Kombëtare të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore- Kuadri Strategjik dhe Plani Kombëtar i Veprimit 2005-2007, miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 25, datë 22.2.2005 "Për miratimin e Planit të Veprimit, për periudhën 2005-2007, në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore".

Strategjia kombëtare antidrogë 2004-2010, e cila është duke u implementuar, është pjesë e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikut dhe terrorizmit.

## **Strategjia ndërsektoriale e menaxhimit të integruar të kufijve**

Tre ministritë kryesore për hartimin Projektit për "Menaxhimin e Integruar të Kufijve", janë Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Më datë 20 Nëntor 2006 u organizua ceremonia e dorëzimit zyrtar të këtij projekti të Qeverisë Shqiptare. Në hartimin e këtij projekti dhe Planit të tij të Veprimit, janë mbajtur parasysh rekomandimet e Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor dhe praktikrat e mira të Katalogut Schengen. Nga partnerët ndërkombëtar, ky projekt është vlerësuar si një nga projekt-strategjitë më të mira të vendeve të Ballkanit. Për zbatimin e Planit të Veprimit dhe përlllogaritjen e kostos financiare është përgatitur praktika dhe një Projekt-Urdhër i Kryeministrit për ngritjen e Komitetit Koordinues për zbatimin e Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe Planit të tij të Veprimit. Ky Projektligj është dërguar në Këshill të Ministrave për shqyrtim.

Janë duke u ndjekur procedurat për miratimin e kësaj strategjie dhe planit të saj të veprimit.

## **Strategjia ndërsektoriale e administratës publike**

Strategjia e fundit e miratuar nga Qeveria Shqiptare për çështjet që lidhen me Administratën Publike, e ka filluesën e saj që në vitin 1999 me një vendim të Këshillit të Ministrave për miratimin e "Strategjisë për Reformën Institucionale dhe Administratën Publike". Disa nga objektivat kryesore të kësaj strategjie janë realizuar, ndërsa disa të tjera janë tejkaluar nga zhvillimet më të fundit në këtë fushë. Qeveria Shqiptare ka miratuar një legjislacion gjithëpërfshirës për shërbimin civil. Ka kryer një ndërhyrje të rëndësishme në sistemin e pagave të nëpunësve të administratës publike si dhe ka ndërmarrë disa iniciativa në fushën e rishikimeve funksionale të institucioneve kryesore shtetërore. Arritjet në këto fusha, janë gërshetuar edhe me identifikimin e problemeve të dala nga aplikimet në praktikë dhe janë krijuar kushtet për fillimin e punës për hartimin e një strategjie afatgjatë, për të përcaktuar hapat strategjike që do të ndiqen nga Qeveria.

## **Qëllimet**

Politika e këtij sektori është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Përmirësimi në vazhdimësi i aftësive drejtuese të stafit të Ministrisë së Brendshme dhe niveleve të tjera të vendimmarrjes. Afrimi i kushteve të punës me standardet e BE. Krijimi i një sistemi unik dhe të informatizuar të kontabilitetit brenda vitit 2010 me qëllim rritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve të administratës publike. Përmirësimi i strukturave procedurave dhe sistemeve; përmirësim i cilësisë së shërbimeve dhe produkteve. Zbatimi me korrektësi i akteve ligjore dhe nënligjore nga të gjitha strukturat.
- Shkolla e Policisë është një institucion që duhet të zhvillojë në vazhdimësi kurrikulat dhe nëpërmjet trajnimit dhe rehabilitimit të infrastrukturës që bazohet tek standardet dhe praktikrat ndërkombëtare, të përgatisë punonjës policie të afte profesionalisht.

- Programi i Policisë së Shtetit zhvillon dhe rishikon strategjitë dhe politikat në kontrollin e kufirit duke synuar rritjen e standardeve. Rritja e sigurisë rrugore duke synuar një ulje të aksidenteve rrugore 25% deri në vitin 2009. Rikonceptimi dhe miremenaxhimi i burimeve njerëzore, materiale dhe financiare për të bërë me të përdorshme, me të kontrolluara, me fleksibel dhe me të përshtatshme me ndryshimet dhe prioritetet. Përafrimi i legjislacionit të Policisë së Shtetit, sipas rekomandimeve dhe standarteve të BE deri në 2008.
- Përmirësimi i sigurisë së personaliteteve vendas dhe të huaj sa më afër 100% duke siguruar përputhje me standardet me të larta evropiane deri në vitin 2015.
- Mundësimin e një qeverisje qendrore dhe vendore sa më pranë qytetarit dhe në përputhje me nevojat e komunitetit. Decentralizimin e pushtetit me synim transferimin e kompetencave të shërbimeve publike nga pushteti qendror në nivel vendor dhe garantimi i shërbimeve publike në tërë territorin nëpërmjet shpërndarjes së transfertave të buxhetit të shtetit mbështetur në kapacitetet fiskale vendore. Rritja e sigurisë së jetesës së individit dhe garantimit të pronës nëpërmjet një bashkëveprimi të koordinuar sa më optimal të veprimtarisë së institucionit të prefektit të Policisë së Rendit, si dhe sigurimin e bashkërendimit me të plotë të organeve të policisë së shtetit me institucionet e tjera qendrore në nivel vendor dhe organeve të qeverisjes vendore, për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike.
- Modernizimi i Shërbimit të Gjendjes Civile duke rritur cilësinë e shërbimit ndaj shtetasve për të gjitha shërbimet që ata kryejnë/marrin në zyrat e gjendjes civile. Ky qëllim në vetvete shtrihet në dy plane në qëllimin afat mesëm të ndërtimit të Sistemit të Regjistrimit të Popullsisë dhe në atë afat gjatë të përmirësimit dhe modernizimit të vazhdueshëm të këtij shërbimi me qëllim përputhjen me standardet e Bashkimit Evropian.
- Rritja e numrit të personelit zjarrfikës dhe të efektivitetit të shërbimeve në ndihmë të komunitetit, në përputhje me standardet evropiane.
- Përmirësimet e ndjeshme në indikatorët që influencojnë në rritjen e sigurisë së qytetareve të kërcënuar apo goditur nga fatkeqësi që shkaktojnë emergjencë civile, nëpërmjet planifikimit dhe realizimit të masave mbrojtëse, përgjigjes së kualifikuar dhe të organizuar ndaj fatkeqësive, duke përmirësuar sistemin e parashikimit, planifikimit, organizimit, edukimit, parandalimit, mbrojtjes, rritjes së kapaciteteve financiare dhe materiale, fuqizimit të logjistikës dhe modernizimit të teknologjisë së informacionit, në strukturat planifikuese dhe aktive vepruese të shërbimit të emergjencave civile. Përafrimi i legjislacionit në fushën e emergjencave civile me legjislacionin e BE. Rritja e shkallës së gadishmerisë dhe të informimit, përgatitjes tekniko - profesionale, për strukturat e emergjencave civile dhe kulturës qytetare.

## **3 Programet buxhetore të Ministrisë**

### **3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM**

Politika e këtij programi konsiston ne zhvillimin e politikave dhe strategjive ministeriale. Ai koordinon dhe monitoron performancën e programeve të ministrisë, veçanërisht për të promovuar një përdorim me eficient dhe efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare. Ky program përcakton menaxhimin dhe mbështetjen administrative për programet e tjera të ministrisë, veçanërisht në vazhdimësinë e zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në të gjitha nivelet e ministrisë për të bërë të mundur përgatitjen, zhvillimin dhe implementimin e politikave dhe kuadrit ligjor në përputhje me standardet e BE-se.

### **3.2 ARSIMI DHE SHKENCA (AKADEMIA)**

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulave për të arritur standardet që kërkohen. Përmirësimin e aftësive profesionale të trupës pedagogjike nëpërmjet përvetësimit të kurrikulave dhe aftësimit në praktike të kursanteve dhe studenteve. Përmirësimin e infrastrukturës mësimore dhe i mjeteve didaktike për zhvillimin e mësimin. Përmirësimi i kushteve të akomodimit të personelit, studenteve dhe kursanteve.

### **3.3 POLICIA E SHTETIT**

Politika e këtij programi konsiston në ngritjen në një nivel më të lartë e bashkëkohor të veprimtarisë së strukturave të Policisë së Shtetit, për përafrimin e standardeve dhe procedurave të operimit të policisë me ato të vendeve të BE, për t'i shërbyer me mirë komunitetit dhe thellimit të bashkëpunimit me të, me synimin rritjen e besimit, për një bashkëpunim sa më efektiv brenda dhe jashtë vendit, për një planifikim dhe përdorim sa më racional të burimeve njerëzore e materiale.

### **3.4 GARDA E REPUBLIKES**

Politika e këtij programi konsiston në ruajtjen e Presidentit të Republikës, Kryetarit e Kuvendit, Kryeministrin si dhe familjet e tyre, personalitetet e larta të këtij rangu që vizitojnë vendin tonë, Kryetarit e Gjykatës Kushtetuese, Zv/kryetarët e Kuvendit, anëtarët e KM, Kryetarit e Gjykatës së Lartë, Prokurorin e Përgjithshëm, Kryetarin e KLSH, Guvernatorin e Bankës së Shtetit, Avokatin e Popullit, Kryetarin e KOZ-së, Kryetarin e Maxhorances, Kryetarin e Partisë më të madhe të Opozitës Parlamentare, Kryetarin e Bashkisë së Tiranës si edhe banesat e tyre.

### **3.5 PREFEKTURAT DHE FUNKSIONET E DELEGUARA TË PUSHTETIT VENDOR**

Politika e këtij programi konsiston në ndjekjen dhe marrjen e masave për plotësimin nga të gjitha institucionet në nivel qarku të detyrimeve që ata kanë për të garantuar sovranitetin, rendin kushtetues dhe shëndetin publik. Në realizimin e shërbimit të mbikëqyrjes kontrollit dhe bashkërendimit të veprimtarive të institucioneve qendrore në nivel vendor për zhvillim lokal dhe rajonal në fushën e përmirësimit të infrastrukturës rurale dhe urbane, në sektorin e ujit të pijshëm, planifikimit urban si dhe të verifikimit të ligjshmerisë së akteve të miratuara nga organet e qeverisjes vendore në komuna bashki e qark, kryen shërbimin e kontrollit financiar mbi këto organe në mënyrën dhe limitet e përcaktuara me ligj.

### **3.6 SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE**

Politika e këtij programi konsiston në shërbimin e regjistrimit dhe përditësimit të të dhënave të shtetasve në Regjistrat Themeltare të Gjendjes Civile. Informacioni i shërbimit të gjendjes civile është tërësia e të dhënave personale, që vërteton lindjen, ekzistencën, individualitetin e shtetasve, si dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Këto të dhëna shërbejnë për realizimin dhe

mbrojtjen e të drejtave të shtetasve në marrëdhëniet me shoqërinë e shtetit shqiptar, si dhe për ushtrimin e funksioneve të organeve dhe institucioneve shtetërore.

### **3.7 SHERBIMI I MBROJTJES NGA ZJARRI**

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e shërbimit të ndërhyrjes në raste zjarresh dhe fatkeqësish të tjera, në ndihmë të komunitetit, për mbrojtjen e jetës dhe pronës, nëpërmjet fuqizimit të strukturës parandaluese dhe operuese në të gjithë elementët sipas standardeve të përcaktuara në fushën e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtimin, në përputhje me konventat e Këshillit të Evropës në këtë drejtim.

### **3.8 EMERGJENCAT CIVILE**

Politika e këtij programi konsiston në planifikimin, informacionin dhe koordinimin e të gjitha strukturave të Shërbimit të Emergjencave Civile dhe garantimin e përdorimit të të gjitha burimeve të mundshme të shtetit, me qëllim rritjen e sigurisë publike, lokalizimin e zonës së emergjencës, lehtësimin e pasojave, reagimin e integruar të strukturave përkatëse dhe riaftësimin e zonës së dëmtuar, përafrimi në standarde ndërkombëtare të shërbimeve të mbrojtjes të jetës së qytetareve, pronës private dhe publike, trashëgimisë kulturore nga emergjenca civile, nëpërmjet fuqizimit të strukturave planifikuese, strukturave operacionale aktive dhe mbështetëse, strukturave parandaluese dhe kontrolluese, sistemeve të integruara të komunikimit, fondeve dhe resurseve mbështetëse, edukimit, trajnimit, bashkëpunimit me organet e qeverisjes vendore dhe struktura ndërkombëtare analoge.

## 4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2007. Këto produkte përbëjnë Planin e Monitorimit të Ministrisë.

### 4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

#### *Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm (SHKB)*

##### 1. Objektivat e politikës

- Përmirësimi i infrastrukturës ligjore (Ligji i SHKB-së dhe rishikimi i të gjitha akteve të saj normative).
- Nëpërmjet trajnimeve intensive dhe cilësore të sigurohet rritja e cilësisë në punën informuese- analizuuese - procedurale dhe verifikuese mbi veprimtarinë e kundërligjshme që kryhet nga individë të veçantë të Policisë së Shtetit dhe sidomos ndaj veprimeve korruptive.

##### 2. Aktivitetet kryesore të parashikuara për t'u realizuar

- Rritja e cilësisë në procesin e hetimit të çështjeve penale në përgjithësi e ato në fushën korruptive në veçanti.
- Përmirësimi i imazhit të këtij shërbimi, duke e konsideruar atë si një agjenci civile e zbatimit të ligjit.
- Rritja e cilësisë së informacionit për problemet që do të trajtohen dhe përfshihen në strategjinë kombëtare antikorrupsion nëpërmjet së cilës do të rritet numri i kallëzimeve penale në Prokurori për punonjësit e policisë të cilët janë të implikuar në veprimtari të kundërligjshme.

#### *Administrata publike*

##### 1. Objektivat e politikës

- Plotësimi i kërkesave për trajnimin e nëpunësve civil sidomos në fushën e aftësive menaxheriale
- Të ndryshohet ITAP për të qenë një organizatë e orientuar nga kërkesa, klienti dhe kujdesi për klientin dhe të promovohet i njëjti qëndrim brenda institucioneve dhe agjencive të shërbimit civil.

##### 2. Aktivitetet kryesore të parashikuara për t'u realizuar

- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të performancës. Qëllimi është të krijohet një sistem objektiv i përcaktimit të objektivave institucionale, të cilat lidhen me objektivat individuale të nëpunësve dhe në fund të vitit bëhet një bilanc i realizimit të tyre. Gjithashtu, synohet të kemi një lidhje direkte mes performancës individuale dhe sistemit të shpërblimeve, zhvillimit të karrierës, etj.
- Krijimin dhe zbatimin e skemave shpërblyese për nëpunësit publikë. Qëllimi është të diferencohen nëpunësit publikë mbështetur në kualifikimet e tyre, për të tërhequr dhe mbajtur në administratë kuadro të aftë profesionalisht. Për këtë arsye do të ndryshohet struktura e pagës, duke parashikuar shpërblime shtesë për nëpunësit që kanë kryer studime pasuniversitare (master, doktoraturë).

- Vënia në funksionim e një sistemi modern të menaxhimit të burimeve njerëzore. Synohet vënia në funksionim e bazës qendrore të të dhënave për nëpunësit publikë, e cila do të shërbejë si bazë informacioni për të gjithë nëpunësit publikë, për kryerjen e parashikimeve lidhur me stafin dhe eksperimentimin e skenarëve të ndryshëm për reforma në fushën e pagave.

### ***Shërbimet mbështetëse***

#### **1. Objektivat e politikës**

- Rikonstruksion i ambienteve të Ministrisë, kompletimi me pajisje zyrash bashkëkohore duke siguruar përmirësim të kushteve të punës.
- Rinovim i sistemit IT në godinën e Ministrisë së Brendshme, konfigurim i rrjetit të brendshëm dhe parashikimi i mbulimit me shërbim interneti, blerje pajisjesh, hardware dhe rrjeti si server, PC, UPS, etj si dhe software për mbrojtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paligjshme dhe viruset.

#### **2. Aktivitetet kryesore të parashikuara për t'u realizuar**

- Rritja e profesionalizmit të punonjësve
- Përmirësim i dukshëm në shërbimin me njësitë e varësisë, njësitë e Qeverisjes Vendore dhe marrëdhëniet me Publikun dhe me partnerët e huaj.
- Standardizimi dhe licencimi i rrjetit të brendshëm të ministrisë nga DSIK, në përputhje me rekomandimet dhe standardet e NATO-s dhe Komunitetit Evropian.
- Reduktimi i shpenzimeve operative si letër, bojë, pajisje printimi dhe fotokopjimi, etj.

### ***Auditimi i Brendshëm***

#### **1. Objektivat e politikës**

- Hartimi dhe realizimi i planit vjetor të punës së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2007, i referohet organikës aktuale të kësaj Drejtorie. Mbi bazën e problemeve të konstatuara, detyrimeve ligjore për auditimin, objektiveve dhe detyrimeve që ka Institucioni, realizimit të objektiveve të auditimit dhe mundësive reale për auditim,

#### **2. Aktivitetet kryesore të parashikuara për t'u realizuar**

- Drejtorja e Auditimit të Brendshëm, për vitin 2007 do të realizojë 24 auditime të plota, krahas atyre tematike në sistemin e Ministrisë Brendshme dhe verifikime detyrash të lëna nga auditimet e kryera në vitin 2006, të cilat në mënyre analitike ju janë prezantuar në Programin e punës të miratuar për vitin 2007.

### ***Anti-trafik***

- Monitorimi i vazhdueshëm i aktiviteteve të institucioneve të ngarkuara për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore- Kuadri Strategjik dhe Plani Kombëtar i Veprimit 2005 dhe bashkërendimi i punës me këto institucione për realizimin e objektiveve të përcaktuara;
- Funksionimi efikas i strukturave kombëtare të referimit të viktimave të trafikimit, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal;
- Funksionimi i plotë i Autoritetit Përgjegjës si Mekanizëm Kombëtar Referues (MKR), i cili bashkërendon procesin e referimit për ndihmë dhe mbrojtje fillestare dhe rehabilitimin

afatgjatë të viktimave të trafikimit në bashkëpunim me Ministrinë e Jashtme, Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si dhe me qendrat e strehimit të viktimave të trafikimit;

- Funksionimi i plotë i Komiteteve Rajonale Antitrafik të ngritura me Urdhër të Kryeministrit, marrjen e masave parandaluese, konkretisht, fillimin e fushatave në nivel lokal për heqjen e fëmijëve nga rruga, regjistrimin e tyre në shkollë, luftën kundër prostitucionit ditor etj, në bashkëpunim me policinë, prokurorinë, shërbimet sociale që përfaqësohen në këto komitete etj;
- Ngritja e standardeve të identifikimit dhe mbrojtjes së viktimave në përgjithësi në të gjithë vendin;
- Finalizimin e bazës së të dhënave (database) për rastet e viktimave të trafikimit që janë kthyer, referuar, trajtuar dhe mbrojtur në Shqipëri
- Promovimi dhe zbatimi i Kodit të Sjelljes për Parandalimin e Shfrytëzimit Seksual të Fëmijëve në turizëm, i cili do të nis me një fushatë për Agjencitë Turistike, në funksion të zbatimit të këtij kodi sjellje;
- Vazhdimi i trajnime për punonjësit e policisë në fushën e dhënies së ndihmës ligjore dhe psikologjike viktimave me moshë të mitur, dëshmitarëve ose atyre që janë nën rrezik për trafikim;
- Zbatimi i Marrëveshjes midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Greke "Për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve viktimë të trafikimit";
- Vazhdimi i fushatave ndërgjegjësuese në televizion për të informuar dhe edukuar qytetarët, sidomos të rinjtë, rreth rrezikut, gjasave dhe shkaqeve të trafikimit të qenieve njerëzore dhe nxjerrja e broshurave që do të shpërndahen nga personeli konsullor i huaj dhe shqiptar, të cilat informojnë mbi rreziqet e trafikimit dhe ndihmën e disponueshme jashtë shtetit dhe në Shqipëri;

### ***Shtetësia dhe refugjatët***

- Zbatimi i parimit të Non - Refoulement (moskthimit) të personave të huaj që kërkojnë mbrojtjen e Shtetit Shqiptar.
- Shqyrtimi në mënyrë të drejtë dhe sipas standardeve ndërkombëtare i aplikimeve për azil të paraqitura nga shtetasit e huaj
- Përmirësimi i standardeve të pritjes së azilkërkuesve si dhe implementimi i tyre në përputhje me respektimin e të drejtave themelore të njeriut.
- Realizimi i procesit të integrimit të personave që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë në përputhje me Ligjin nr. 9098, datë 03.08. 2003 "Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar Statusin e Refugjatit në Republikën e Shqipërisë"
- Vëzhgimi i zhvillimeve të legjislacionit që lidhen me fushën e Azilit.
- Pjesëmarrja në nismat ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit lidhur me përmirësimin e sistemit të azilit në Republikën e Shqipërisë

## **4.2 ARSIMI DHE SHKENCA (AKADEMIA)**

Objektivat e politikës

- Integrimi i Akademisë në një shkollë të njësuar policie për Policinë e Shtetit Shqiptar.
- Trajnim i 15 punonjësve të policisë, të nivelit baze me kohëzgjatje 20 jave.

- Përfundimi i studimeve të 50 studenteve të vitit të tretë deri në korrik 2007.
- Për zhvillimin e menaxhimit dhe lidershit elitë parashikohet një trajnim i përshkallëzuar në trajnim fillestar, të mesëm dhe të avancuar. Ky trajnim do të afrohet afro 50 punonjësve të policisë në terren, po kështu edhe për oficeret e menaxhimit të lartë është planifikuar të fillojnë trajnimin rreth 50 punonjës policie në fillim të vitit 2007; Punonjësit e policisë që do të përfundojnë kursin teorik do të zhvillojnë përgatitjen në terren për 20 javë. Ky trajnim do të zhvillohet nga 165 instruktore të praktikës së përgatitur me para në shkollën e policisë.
- Përmirësim i infrastrukturës së mësimdhënies nëpërmjet shtimit të bazës së materialo-didaktike.

